KËRKESË

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Financave shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimi i pikës së kalimit Bllatë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Ministria e Financave.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vemë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Financave.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentat përkatëse në ministrinë kompetente (Ministrinë e Financave).

Për të gjithë pronarët që në kolonën "shënime" në tabelën e publikuar është bërë shënimi "plotësim dokumentacioni" do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Ministrisë së Financave (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"). Deri në këtë moment paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

Për ato pasuri me pronar "shtet" për të cilat është bërë shënimi "pretendim pronësie", pronarët pretendentë duhet të paraqesin brenda afatit 15-ditor dokumentacionin respektiv të pronësisë ose konfirmimin nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Peshkopisë për të vërtetuar titullin e pronësisë, në të kundërt këto pasuri do të përjashtohen nga shpronësimi.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 683 095 (gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

Nr.	Emër, mbiemer	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar (në lekë)	Vlera në lekë	Shënime
1.	Mexhit Muça	m2	210	673	141 330	
2.	Gani Muça	m2	805	673	541 765	
	Shuma Gjithsej	m2	1 115	673	683 095	